

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6690  
E shtunë, 27 gusht 2022  
çmimi 0.40

LDK-ja: Kërcënimi  
i qeverisë ndaj  
grevistëve është praktikë  
autokratike | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

I DËRGUARI AMERIKAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, PAS VIZITËS NË KOSOVË DHE SERBI, KA DHËNË NJË MESAZH PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT

## ESCOBAR: TË GJITHA MARRËVESHJET DUHET TË ZBATOHEN, PËRFSHIRË EDHE FORMIMIN E ASOCIACIONIT



I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, pas vizitës në Kosovë dhe Serbi, ka dhënë një mesazh sa i përket ecurisë së dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka theksuar se Shtetet e Bashkuara nuk janë pjesë e dialogut, por e mbështesin dialogun

e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Escobari ka thënë se dialogu duhet të vazhdojë dhe të gjitha marrëveshjet e arritura duhet të zbatohen, përfshirë këtu edhe formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

### AKTUALE



META DREJTON AKUZA NË DREJTIM TË RAMËS: KRIZA NË SHQIPËRI PO VAZHDON TË RËNDOHET | F. 7

RUSIA LËSHON FLETARRESTIM PËR FOTOGRAFEN RUSE TË NDALUAR NË SHQIPËRI | F. 2

ADEM GRABOVCI VIZITON KRERËT E UÇK-SË NË HAGË: DO TA FITOJMË EDHE KËTË BETEJË | F. 5

### EKONOMI



VAZHDHET MARRËVESHJA QË MBAN KOSOVËN TË PAVARUR NGA RRJETI SERB I TRANSMISIONIT TË ENERJISË | F. 8

PARISI DHE MUNIHU, QYTETET ME PATUNDSHMËRINË MË TË SHITRENJTË NË EVROPË | F. 8

### SPORT



BALLKANI MËSON KUNDËRSHTARËT NË LIGËN E KONFERENCËS | F. 10



SBASHK-u: GREVA DO TË VAZHDOJË DERISA QEVERIA TË REFLEKTOJË | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
[info@kolegji.biznesi.com](mailto:info@kolegji.biznesi.com)  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Shefi i OBSH-së: Nuk mund t'i ndihmoj familjes sime të uritur në Etiopi

**GJENEVË, 26 GUSHT** - Shefi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Tedros Ghebreyesus, ka thënë se nuk mund t'u dërgojë të holla familjarëve "të uritur" në rajonin Tigray në Etiopi.

Ky rajon është shkatërruar si pasojë e luftës. "Kam shumë familjarë atje. Dua t'u dërgoj para, por nuk mundem", ka thënë ai në një konferencë për media.

"Nuk e di se kush është i gjallë e kush i vdekur", ka vazhduar ai.

Prej kur ka nisur lufta më 2020, ky rajon është shkëputur nga pjesa tjetër e botës, pa qasje në telefon apo internet.

Qeveria e Etiopisë është akuzuar për vënie të bllokadës në këtë rajon, e cila ka penguar furnizimet. Vetë Qeveria ka thënë se lufta është fajtoje për mungesa furnizimesh.

Programi Botëror për Ushqim ka thënë se pothuajse gjysma e

popullsisë prej 5.5 milionë banorësh në Tigray, ka nevojë të madhe për ushqim.

Kjo nuk është hera e parë që Tedros, ish-ministër i Shëndetësisë në Etiopi, ka folur për luftën.

Të mërkurën, ai ka thënë se situata është më e keqe se në Ukrainë dhe ka sugjeruar se racizmi është mbrapa mënyrës sesi u është përgjigjur bota këtyre konflikteve.

"Mund t'ju them se kriza humanitare në Tigray është më e madhe sesa në Ukrainë, pa e ekzagjeruar. E kam thënë shumë muaj më parë, ndoshta arsyeja qëndron te ngjyra e lëkurës së njerëzve në Tigray".

Luftimet kanë nisur sërish këtë javë në këtë rajon, pas një armëpushimi të arritur në mes të forcave të Tigrayt dhe Qeverisë së Etiopisë.

Lufta ka shpërthyer më 2020, pasi kryeministri, Abiy Ahmed,



ka urdhëruar dërgimin e trupave në Tigray për të rrëzuar Fronti Popullor Çlirimtar (TPLF), duke akuzuar rebelët se kanë sulmuar kampet ushtarake federale.

Ky vendim është marrë pas disa muajsh tensione mes Qeverisë dhe TPFL-së, e cila ka dominuar politikën e Etiopisë për tri dekada, derisa Abiy ka marrë pushtetin më 2019.

Si pasojë e luftimeve në shtetin e dytë më të madh të Afrikës, mijëra njerëz janë vrarë, miliona janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre dhe shumë të tjerë janë përballur me varfëri.

## Rusia lëshon fletarrestim për fotografen ruse të ndaluar në Shqipëri

**MOSKË, 26 GUSHT** - Një gjykatë në Moskë ka lëshuar fletarrestim për Svetlana Valeryevna Timofeyeva, të dhënat personale të së cilës përkohësisht me të dhënat e një gruaje që është ndaluar në Shqipëri, nën akuzat për spiunim.

Gjykata në distriktin Meshchsky, ka thënë më 26 gusht se ka shtuar Timofeyevan, e cila është akuzuar se në mënyrë të paligjshme ka siguruar informacion të klasifikuar në listën e personave që kërkon nëpër botë.

Emri i saj i plotë dhe data e lindjes - 19 mars 1989 - që janë përmendur në gjykatë lidhur me Timofeyevan, janë të dhëna të njëjta sikurse të fotografes ruse, Svetlana Timofeyeva, e cila po ashtu njihet si Lana Sator.

Ajo është arrestuar ditë më parë në Shqipëri, bashkë me dy burra tjerë.

Timofeyeva njihet si fotografe që



shkrep fotografi të fabrikave funksionale dhe atyre të braktisura, dhe i publikon në

llogarinë e saj në Instagram, në të cilën ka mbi 250 ndjekës. Timofeyeva dhe dy burrat tjerë,

njëri rus, Mikhail Zorin, dhe tjetri ukrainas, Fedir Mykhaylov, janë ndaluar më 20 gusht në Shqipëri,

vend anëtar i NATO-s.

Shqipëria po ashtu mbështet Ukrainën teksa mbrohet nga pushtimi rus.

Fabrika e armëve në Gramsh është hapur më 1962 për të prodhuar pushkë të llojit AK-47 dhe armë tjera.

Aty është ndalur prodhimi pas rënies së komunizmit më 1990 dhe më pas ka nisur shkatërrimi i armëve.

Fabrika përdoret ende për të riparuar armë ushtarake, mirëpo nuk prodhon më të tilla.

Autoritetet shqiptare kanë thënë se Timofeyeva dhe Mykhaylov janë ndaluar afër fabrikës, ndërsa Zorin ka qenë brenda.

Ai ka hedhur sprej pipëri ndaj dy roje ushtarëve që kanë tentuar të kapin.

Më 24 gusht, autoritetet në Shqipëri kanë marrë vendim që tre personat të qëndrojnë në burg derisa të përfundojnë hetimet.

## Papa Françesku i kërkon Koresë së Veriut ta ftojë për vizitë

**Vatikan, 26 gusht** - Papa Françesku i ka kërkuar Phenjanit që ta ftojë në Korenë Veriore, duke thënë se nuk do ta refuzonte mundësinë për ta vizituar këtë vend dhe për të punuar për paqe.

Një vizitë e mundshme e Papës në shtetin e izoluar është përmendur më 2018 kur ish-presidenti i Seulit, Moon Jae-in, pati nisur një rund të bisedimeve diplomatike me liderin e Phenjanit, Kim Jong Un.

Moon, i cili është katolik, ka thënë gjatë samitit se Kim i ka

thënë që Papa do të ishte i mirëpritur.

Papa Françesku ka thënë atëbotë se ka gatishmëri për të bërë vizitën, nëse pranon ftesë zyrtare. Megjithatë, Phenjani ka shkëputur në masë të madhe kontaktet me Seul, si pasojë e dështimit të samitit të dytë në mes të Kimit dhe ish-presidentit amerikan, Donald Trump më 2019.

"Kur ata më ftojnë - po e them, ju lutem më ftoni - nuk do të them jo", ka thënë Papa Françesku për transmetuesin jugkorean, KBS. "Qëllimi është thjesht të vllazërimi", ka

shtuar ai.

Lidhjet në mes të Koresë Veriore dhe asaj Jugore janë ftohur edhe më shumë pas inaugurimit të presidentit të ri në Seul, Yoon Suk-yeol.

Yoon ka ofruar ndihmë për Korenë Veriore në kthim të çarmatosjes, mirëpo Kim ka hedhur poshtë diçka të tillë.

Koreja Veriore ka kryer disa testime raketore këtë vit, përfshirë raketën balistike interkontinentale me reze të gjatë veprimi, për herë të parë prej vitit 2017.

Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të



Bashkuara ia ndalojnë Koresë së Veriut testimet e raketave

balistike apo testime tjera bërthamore.

# Çfarë parasheh Projektligji për Paga?

Prishtinë, 26 gusht - Përcaktimi i vlerës monetare të një koeficienti për pagat e shërbyesve civilë është një ndër debatet që ka përfshirë sindikatat e punëtorëve.

Ministria e Punëve të Brendshme e ka proceduar projektligjin për paga në konsultime paraprake më 17 gusht, qëllimi i të cilit është përcaktimi dhe rregullimi i sistemit të pagave dhe shpërblimeve për të gjithë të punësuarit që përfitojnë pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Pagat e punëtorëve në Kosovë llogariten duke e shumëzuar koeficientin e pagës për pozitën (nga 1 - 18 sipas projektligjit aktual) me vlerën monetare të koeficientit.

Zyrtarisht ende nuk dihet sa është koeficienti.

Projektligji i pagave për sektorin publik, një kopje të të cilit e posedon Radio Evropa e Lirë, nuk e cakton vlerën e koeficientit. Aty thuhet se “vlera monetare e koeficientit përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit”.

Raporti i koeficienteve është 1:18.

## Cilët janë skenarët për vlerën monetare të koeficientit?

Në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) thonë se nga zyrtarë të Qeverisë së Kosovës iu është thënë se vlera monetare e koeficientit do të jetë 120 euro.

Sipas burimeve të “Radios Evropa e Lirë” brenda institucioneve të Kosovës, të cilat kanë qenë pjesëmarrëse në grupe punuese të projektligjit për paga, thonë se në ato takime janë diskutuar edhe vlerat monetare prej 130 ose 250 eurosh.

Sipas tyre, nëse vlera e koeficientit caktohet të jetë 120 euro apo 130 euro, atëherë raporti i koeficientit do të jetë ashtu siç është aktualisht në projektligj, 1-18.

Nëse vlera e koeficientit do të jetë 250 euro, është diskutuar që raporti i koeficientit të ulet nga 1 deri në 10, e jo aq sa është në projektligj 1-18.

Përcaktimi i këtyre vlerave monetare për koeficientin do të bëhet varësisht sa do të jetë buxheti i Kosovës për vitin 2023. Ky ligj zakonisht hartohet deri në fundvit.



## Kush sa e ka koeficientin?

Me projektligjin për pagat e shërbyesve civilë, koeficienti më i lartë, 18, i takon vetëm presidentit të Kosovës.

Paga aktuale e presidentes është 2.743 euro. Me projektligjin e ri, nëse vlera monetare e koeficientit është 120 euro, atëherë kjo pagë zbritet dhe është 2.160 euro.

Niveli i koeficientit 17.5 i takon kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Paga aktuale për këtë pozitë është 3.574 euro. Me projektligjin e ri me vlerë të koeficientit 120 euro, paga zbritet dhe atë në 2.100 euro. Koeficienti 17 i takon kryetarit të Kuvendit të Kosovës, si dhe kryeministrit.

Te kryeministri, i cili aktualisht pagën e ka 1.075.25 euro, me projektligjin e ri, nëse vlera monetare e koeficientit do të jetë 120 euro paga rritet në 2.040 euro. Rritje të pagave do të ketë për mjekët specialistë, mësimdhënësit dhe policët.

Për mjekët specialistë, projektligji për paga ka vendosur koeficientin 12, ndërkaq, për mësimdhënësit në shkollat fillore dhe ato të mesme të

ulëta, koeficienti është 5.6.

Paga aktuale e mjekëve specialistë është 600 euro, e cila me vlerë monetare të koeficientit 120 euro rritet në 1.440 euro.

Për mësimdhënësit në shkollat fillore, të cilët marrin pagë mujore 470 euro, me vlerë monetare të koeficientit 120, ajo rritet në 672 euro.

Sipas projektligjit, mësimdhënësit në shkollën e mesme të lartë, do ta kenë koeficientin 5.8. Paga aktuale e një mësimdhënësi në shkollë të mesme të lartë është 525 euro, me vlerë monetare të koeficientit 120 rritet në 696 euro.

Për mësimdhënësit në arsimin e mesëm të ulët, koeficienti me projektligjin e ri është 5.6.

Paga e një mësimdhënësi në shkollë të mesme të ulët është 530 euro, me vlerë monetare të koeficientit 120 rritet në 672 euro.

Me projektligjin e ri për pagat, koeficienti për policët është 4.4. Paga aktuale e një polici është 392 euro, ndërsa me vlerë monetare të koeficientit 120 euro rritet në 528 euro.

Koeficienti më i ulët në këtë projektligj është 2 dhe ai iu takon pozitave si: rekrut/ kadet i

Forcës së Sigurisë së Kosovës, kadet policor, kadet doganor dhe kadet korrektues.

Projektligji për pagat e shërbyesve civilë ka paraparë edhe ulje të nivelit të pagës. Sipas këtij projektligji, vlera monetare e koeficientit mund të ulet vetëm me ligj dhe atë për situatat si në vijim: “Një tronditje makroekonomike, e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

Projektligji duhet të kalojë procedurat e konsultimeve paraprake dhe publike, si dhe pas miratimit në Qeveri e Kuvend, do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj hyn në fuqi tetë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Numri i punonjësve që marrin paga nga buxheti i Kosovës është rreth 83 mijë veta.

Paga mesatare bruto për vitin 2021, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, është 484 euro.

## Ligji i shfuqizuar kishte koeficientin 239 euro

Ligji paraprak për pagat e shërbyesve civilë i cili ishte shfuqizuar, kishte vlerën monetare të koeficientit 239 euro për vitin e parë të zbatimit të këtij ligji.

Raporti i koeficienteve sipas këtij ligji, ishte një me dhjetë.

Ligji i pagave ishte miratuar një herë në shkurt të vitit 2019. Por, një muaj para se të niste zbatimin i tij - në janar të 2020-s - institucioni i Avokatit të Popullit e pati dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese për, siç ka thënë, “vlerësimin e përputhshmërisë” së tij me Kushtetutën e Kosovës.

Gjykata, më pas, ka konstatuar se ligji i miratuar nuk është në përputhje me 11 nene të Kushtetutës dhe se shkakton “çrregullim të ndarjes së pushteteve në disfavor të Gjyqësorit dhe institucioneve të pavarura”.

Ligji është shfuqizuar dhe që nga ajo kohë ka mbetur pezull, kryesisht për shkak të zhvillimeve politike që kanë përfshirë disa palë zgjedhje në vend.

## SBASHK-u: Greva do të vazhdojë derisa qeveria të reflektojë

PRISHTINË, 26 GUSHT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës ka njoftuar se të premten ka vizituar komunën e Lipjanit dhe të Shtimes, me ç'rast kanë vizituar edhe shkollën “Ismail Luma” në Lipjan dhe çerdhen e kësaj komune dhe, po ashtu, shkollën “Emin Duraku” në komunën e Shtimes.

Sipas SBASHK-ut, gjatë takimit me sindikalistët u bisedua për ecurinë e grevës si dhe për

kërcënimet dhe presionet që kanë filluar të zhvillohen karshi sindikalistëve grevistë. “Përkundër kësaj, grevistët ishin të vendosur të vazhdohet greva pa marrë parasysh presionet kush i bën dhe nga vijnë deri në realizimin e kërkesave tona që janë të njohura për publikun. Përfaqësuesit e nivelit qendror të SBASHK-ut u thanë sindikalistëve se ata do të qëndrojnë të vendosur për t'i

realizuar kërkesat e tyre, ndërsa për presionet u informuan se zyra ligjore pranë BSPK-së do të analizojë këto presione e kërcënime dhe do të përgatisë kallëzim penal karshi atyre që kanë filluar t'i bëjnë këto presione ose edhe ata që do t'i bëjnë. Greva vazhdon në gjithë Kosovën derisa qeveria të reflektojë dhe të bëjë zgjidhje për kërkesat tona”, ka njoftuar SBASHK-u.





I DËRGUARI AMERIKAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, PAS VIZITËS NË KOSOVË DHE SERBI, KA DHËNË NJË MESAZH PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT

## Escobari: Të gjitha marrëveshjet duhet të zbatohen, përfshirë edhe formimin e asociacionit

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, pas vizitës në Kosovë dhe Serbi, ka dhënë një mesazh sa i përket ecurisë së dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka theksuar se Shtetet e Bashkuara nuk janë pjesë e dialogut, por e mbështesin dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Escobari ka thënë se dialogu duhet të vazhdojë dhe të gjitha marrëveshjet e arritura duhet të zbatohen, përfshirë këtu edhe formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 26 gusht - I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë të premtën se qëllimi i vizitës së tij në Kosovë dhe Serbi këtë javë është për t'i mbështetur përpjekjet e Bashkimit Evropian për gjetjen e zgjidhjes mes Kosovës dhe Serbisë për tregat e makinave dhe dokumentet serbe.

Ai i ka bërë këto deklarata në një konferencë për medie në Ambasadën Amerikane në Beograd.

Escobari ka thënë se dëshiron që

të dyja palët të zotohen se nuk do të ketë dhunë. "Dialogu nuk është klinikisht i vdekur. Unë nuk jam pjesë e dialogut, Shtetet e Bashkuara nuk janë pjesë e dialogut, por ne mbështesim dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Shpresoj që deri në fund të muajit ne do të gjejmë rrugë për të vazhduar. Në të njëjtën kohë, dialogu do të vazhdojë. Të gjitha marrëveshjet do të duhet të zbatohen, përfshirë formimin e Asociacionit. Ne u kemi thënë liderëve të Kosovës dhe Serbisë se ne presim që çështja e zbatimit të të gjitha marrëveshjeve ekzistuese të jetë

në agjendën e takimit të radhës. Ne nuk presim që të arrihet marrëveshje atëherë, mirëpo natyrisht që presim të jetë në agjendë", ka thënë Escobari.

Escobari ka bërë me dije se faktori ndërkombëtar do të vazhdojë të kërkojë nga të dyja palët që të garantojnë paqe dhe stabilitet. "Agjenda e dialogut është krijuar nga përfaqësuesi i BE-së. Çështja më e rëndësishme është zotimi i liderëve dhe këtë e kemi marrë nga ata. Roli ynë është që ata t'i zbatojnë këto zotime në mënyrë që të arrihet marrëveshja", ka thënë ai.

Gjatë konferencës, Escobari ka thënë se shpreson që më 1 shtator të mos ngarkohet jetesa e banorëve në veri të Kosovës dhe ata të jetojnë në paqe. "Shpresoj se ata nuk do të kenë nevojë për procedura administrative shtesë për të shkuar në shtëpitë e tyre. Besoj se do të mund të arrijmë këtë gjë", është shprehur Escobari.

Ai ka përmendur nevojën e ndërtimit të besimit. "Mund t'i them publikut në Serbi që kemi dëgjuar shqetësimet e tij. Në disa raste ka shumë retorikë që nuk na

ndihmon, mirëpo në shumicën e rasteve ka shqetësime serioze për serbët në Kosovë. Ka mungesë të madhe besimi, dhe ne jemi duke punuar për ndërtim të tij", ka deklaruar ai.

Sa iu përket bisedimeve, ai ka thënë se ato kanë qenë të vështira. "Bisedimet kanë qenë të vështira, sepse është dashur të bëhen shumë kompromise nga të dyja anët. Ka qenë proces i vështirë, sepse ekzistojnë dallime të mëdha në pikëpamjet e palëve negociuese. Kam parë gatishmëri për të gjetur zgjidhje dhe për të krijuar besim në proces, por edhe nga ana e BE-së që të jetë ndërmjetësuese e vërtetë", ka thënë Escobari.

Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se me Vuçiqin kanë pasur një diskutim të vështirë. "Pata një diskutim të vështirë, por të përgjegjshëm me presidentin Vuçiq. I përcolla mesazhet dhe theksova se të gjitha marrëveshjet e dala nga dialogu duhet të zbatohen, përfshirë edhe Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes

të vitit 2011. Ne do t'i vazhdojmë bisedimet tona më vonë sonte", ka shkruar ai në "Twitter".

Për "takim të vështirë" foli edhe presidenti serb. "Kemi pasur biseda të vështira me Lajçakun dhe Escobarin. Aty ishin edhe ambasadori i ShBA-së dhe ai i BE-së. Vazhdojmë sonte me bisedime pas orës 22:00", ka thënë Vuçiqi në një video-adresim në "Instagram". "Gjithmonë do të përpiqemi ta ruajmë paqen dhe stabilitetin, do të luftojmë për paqen dhe stabilitetin, por asnjë sekondë nuk do të devijojmë nga interesat tona jetike, kombëtare shtetërore, mbi të gjitha interesat e popullit tonë. Nuk ka dorëzim", ka theksuar Vuçiqi.

Ai ka thënë se shpreson në një zgjidhje kompromisi me Kosovën për çështjen e tregave dhe dokumenteve serbe.

Vizita e Escobarit dhe Lajçakut në Kosovë dhe Serbi kishte për qëllim shmangien e tensioneve mes dy vendeve.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti serb, Vuçiq, janë takuar më 18 gusht në Bruksel, por takimi nuk ka pasur ndonjë



I DËRGUARI AMERIKAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, PAS VIZITËS NË KOSOVË DHE SERBI, KA DHËNË NJË MESAZH PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT

## Escobari: Të gjitha marrëveshjet duhet të zbatohen, përfshirë edhe formimin e asociacionit

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, pas vizitës në Kosovë dhe Serbi, ka dhënë një mesazh sa i përket ecurisë së dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka theksuar se Shtetet e Bashkuara nuk janë pjesë e dialogut, por e mbështesin dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Escobari ka thënë se dialogu duhet të vazhdojë dhe të gjitha marrëveshjet e arritura duhet të zbatohen, përfshirë këtu edhe formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

Prishtinë, 26 gusht - I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë të premtën se qëllimi i vizitës së tij në Kosovë dhe Serbi këtë javë është për t'i mbështetur përpjekjet e Bashkimit Evropian për gjetjen e zgjidhjes mes Kosovës dhe Serbisë për targat e makinave dhe dokumentet serbe.

Ai i ka bërë këto deklarata në një konferencë për medie në Ambasadën Amerikane në Beograd.

Escobari ka thënë se dëshiron që

të dyja palët të zotohen se nuk do të ketë dhunë. "Dialogu nuk është klinikisht i vdekur. Unë nuk jam pjesë e dialogut, Shtetet e Bashkuara nuk janë pjesë e dialogut, por ne mbështesim dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Shpresoj që deri në fund të muajit ne do të gjejmë rrugë për të vazhduar. Në të njëjtën kohë, dialogu do të vazhdojë. Të gjitha marrëveshjet do të duhet të zbatohen, përfshirë formimin e Asociacionit. Ne u kemi thënë liderëve të Kosovës dhe Serbisë se ne presim që çështja e zbatimit të të gjitha marrëveshjeve ekzistuese të jetë

në agjendën e takimit të radhës. Ne nuk presim që të arrihet marrëveshje atëherë, mirëpo natyrisht që presim të jetë në agjendë", ka thënë Escobari.

Escobari ka bërë me dije se faktori ndërkombëtar do të vazhdojë të kërkojë nga të dyja palët që të garantojnë paqe dhe stabilitet. "Agjenda e dialogut është krijuar nga përfaqësuesi i BE-së. Çështja më e rëndësishme është zotimi i liderëve dhe këtë e kemi marrë nga ata. Roli ynë është që ata t'i zbatojnë këto zotime në mënyrë që të arrihet marrëveshja", ka thënë ai.

Gjatë konferencës, Escobari ka thënë se shpreson që më 1 shtator të mos ngarkohet jetesa e banorëve në veri të Kosovës dhe ata të jetojnë në paqe. "Shpresoj se ata nuk do të kenë nevojë për procedura administrative shtesë për të shkuar në shtëpitë e tyre. Besoj se do të mund të arrijmë këtë gjë", është shprehur Escobari.

Ai ka përmendur nevojën e ndërtimit të besimit. "Mund t'i them publikut në Serbi që kemi dëgjuar shqetësimet e tij. Në disa raste ka shumë retorikë që nuk na

ndihmon, mirëpo në shumicën e rasteve ka shqetësime serioze për serbët në Kosovë. Ka mungesë të madhe besimi, dhe ne jemi duke punuar për ndërtim të tij", ka deklaruar ai.

Sa iu përket bisedimeve, ai ka thënë se ato kanë qenë të vështira. "Bisedimet kanë qenë të vështira, sepse është dashur të bëhen shumë kompromise nga të dyja anët. Ka qenë proces i vështirë, sepse ekzistojnë dallime të mëdha në pikëpamjet e palëve negociuese. Kam parë gatishmëri për të gjetur zgjidhje dhe për të krijuar besim në proces, por edhe nga ana e BE-së që të jetë ndërmjetësuese e vërtetë", ka thënë Escobari.

Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se me Vuçiqin kanë pasur një diskutim të vështirë. "Pata një diskutim të vështirë, por të përgjegjshëm me presidentin Vuçiq. I përcolla mesazhet dhe theksova se të gjitha marrëveshjet e dala nga dialogu duhet të zbatohen, përfshirë edhe Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes

të vitit 2011. Ne do t'i vazhdojmë bisedimet tona më vonë sonte", ka shkruar ai në "Twitter".

Për "takim të vështirë" foli edhe presidenti serb. "Kemi pasur biseda të vështira me Lajçakun dhe Escobarin. Aty ishin edhe ambasadori i ShBA-së dhe ai i BE-së. Vazhdojmë sonte me bisedime pas orës 22:00", ka thënë Vuçiqi në një video-adresim në "Instagram". "Gjithmonë do të përpiqemi ta ruajmë paqen dhe stabilitetin, do të luftojmë për paqen dhe stabilitetin, por asnjë sekondë nuk do të devijojmë nga interesat tona jetike, kombëtare shtetërore, mbi të gjitha interesat e popullit tonë. Nuk ka dorëzim", ka theksuar Vuçiqi.

Ai ka thënë se shpreson në një zgjidhje kompromisi me Kosovën për çështjen e targave dhe dokumenteve serbe.

Vizita e Escobarit dhe Lajçakut në Kosovë dhe Serbi kishte për qëllim shmangien e tensioneve mes dy vendeve.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti serb, Vuçiq, janë takuar më 18 gusht në Bruksel, por takimi nuk ka pasur ndonjë

# LDK-ja: Kërcënimi i qeverisë ndaj grevistëve është praktikë autokratike

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur të premtën një konferencë për medie. Anëtarja e kryesisë, Jehona Lushaku, ka shprehur shqetësimin ndaj kërcënimit që qeveria ua ka bërë një ditë më parë grevistëve të

sektorit publik, përfshirë edhe atyre të arsimit, duke kërkuar që grevistët në fjalë të pezullohen nga lista e pagave. "Kërcënimi i qeverisë ndaj grevistëve të sektorit publik është qasje e paprecedent, ngaqë fyen rëndë integritetin dhe dinjitetin e tyre, duke shkelur kështu edhe një nga të drejtat më bazike të punëtorëve: të drejtën e grevës e

cila garantohet me legjislacionin e vendit tonë dhe me konventa ndërkombëtare", ka thënë Lushaku.

LDK-ja ka vlerësuar se qeveria duhet të dialogojë me grevistët në mënyrë që viti shkollor të fillojë më 1 shtator, pa presion mbi mësuesit dhe pa ngarkesa shtesë për prindërit dhe nxënësit sepse, sipas kësaj partie, qasja e

deritanishme e kësaj qeverie është praktikë tipike e autokratëve. "Kërkimi i listave të grevistëve nga ana e qeverisë, për të dënua ose pezulluar kontratat e tyre, është goditje e ulët dhe pa mbështetje ligjore. Kjo mënyrë, përveçse është presion e frikësim i drejtpërdrejtë, është edhe cenim i demokracisë së vendit tonë. Është praktikë tipike e autokratëve për

t'i heshtur pakënaqësitë me qeverisjen e tij", ka thënë Lushaku. Ajo ka theksuar se krejt kjo po ndodh në kohën kur mësimdhënësi dhe nxënësit, si çdo qytetar tjetër, po përballen me krizën e rritjes së çmimeve, rritjen e çmimit të faturës së energjisë elektrike dhe mungesën e saj, si dhe mosrealizimin e investimeve kapitale nga MASHTI.



rezultat konkret.

Takimet e tyre janë mbajtur pas tensionimit të situatës në veri të Kosovës më 31 korrik meqë serbët lokalë kanë vënë barrikada si shenjë pakënaqësie ndaj hapit të Qeverisë së Kosovës për zbatim të vendimeve për targarat dhe dokumentet serbe.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se autoritetet e Kosovës nuk do ta pranojnë rikthimin në qarkullim të targave KS për veturat brenda territorit të Kosovës si dhe do të zbatojnë masa reciproke për qytetarët e Serbisë sa i përket dokumentit për hyrje/dalje.

**Marrëveshja, Çitaku: Kosova e ka një mundësi të artë me Bidenin në Shtëpi të Bardhë**

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, ka reaguar në lidhje me zhvillimet në vend, sidomos për çështjen e dialogut Kosovë - Serbi. Ajo në "Facebook" ka shkruar se "gjërat duhen parë ashtu siç janë e jo ashtu siç ne do të donim të ishin". "Disa prej nesh kemi mbetur peng i botëkuptimeve të farkëtuara në

vitin 1999. Mirëpo, askush, as në Uashington D.C e as në Bruksel, nuk e sheh rajonin me thjerrëzat e dy dekadave më parë. Aleatët tanë, kur e shohin Kosovën, nuk e shohin një popull të viktimizuar të cilin duhet shpëtuar. Kur e shohin Kosovën, ata shohin një shtet të pavarur dhe sovran, në të cilin kanë investuar gjatë. E shohin një prej demokracive më vibrante në rajon dhe presin nga ne të sillemi përgjegjshëm", ka shkruar Çitaku.

Ajo ka shtuar se: "Kur e shohin Serbinë nuk e shohin një shtet të cilin duhet luftuar. E shohin një shtet i cili sot është problematik, por potencialisht partner, dhe të cilin duan ta ankorojnë kah Perëndimi".

Ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington ka theksuar se bota ka ndryshuar shumë nga viti 1999 dhe nuk ka asnjë apetit për t'u marrë me menaxhim krizash në rajonin tonë. "E ne si Kosovë e kemi një mundësi të artë me Bidenin në Shtëpi të Bardhë, meqë presidenti amerikan ka një kujtesë dhe angazhim personal në rajonin tonë. Mirëpo, kjo mundësi duhet shfrytëzuar konstruktivisht, duke ofruar zgjidhje dhe alternativa, e jo duke shkaktuar probleme artificiale", është shprehur Çitaku.

## Adem Grabovci viziton krerët e UÇK-së në Hagë: Do ta fitojmë edhe këtë betejë

HAGË, 26 GUSHT - Ish-deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, njëherësh bashkëluftëtar i krerëve të UÇK-së, Adem Grabovci, ka njoftuar se i ka vizituar bashkëluftëtarët në Hagë. "Ndonëse për mua nuk ishte hera e parë që përjetova krenarinë e mërzinë, ndjeva mallin e lavdinë për shokët që na mungojnë shumë, jashtë çdo thënie e përshkrimi. Por kësaj radhe ishim bashkë me Frederik Kalaj, kryepiftin e kishës shqiptare në Detroit (ShBA) dhe me shokun tim të Burgut, ish-të burgosurin politik, aktivistin e paepur të çështjes kombëtare, z. Xhevat Ademi, të cilët këtë vizitë e bënë edhe më të veçantë", ka shkruar Grabovci në "Facebook". Ai ka thënë se ata ishin të fortë, të relaksuar dhe të bindur në triumf të drejtësisë e rikonfirmimit të pastërtisë së luftës çlirimtare. "Siç e tha me



shumë emocion krye-pifti Kalaj, lufta mbrojtëse ndaj popullatës civile, pa dallime feje, partie e etnie, është vlera më e madhe e luftës sonë. Këtu beteja është jo

për individët, por për të ardhmen e gjithë kombit. Kemi fituar beteja e beteja, do ta fitojmë edhe këtë si komb të bashkuar", ka shkruar Grabovci.

## Sigurohet ujë i pijshëm për banorët në Verbicë të Kmetocit

**GJILAN, 26 GUSHT** - Ka përfunduar projekti i ndërtimit të sistemit të ujësjes në fshatin Verbicë të Kmetocit, realizuar nga komuna e

Gjilanit në bashkëfinancim me qeverinë zvicerane. Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se ky projekt zgjidh problemin e

kamotshëm të banorëve të fshatit Verbicë. Projekti përfshin ndërtimin e stacionit të pompimit me kapacitet 60 metra kub,

ndërtimin e rezervuarit mbledhës me kapacitet 100 000 litra dhe shtrirjen e rrjetit në gjatësi rreth 4500 metra për 120 shtëpi.



## Lladrovci kërkon nga SPAK-u zgjidhje për lëshimin e dokumenteve urgjente të udhëtimit për mërgimtarë

**DRENAS, 26 GUSHT** - Pas grevës së përgjithshme nga Sindikata e Pavarur e Administratës së Kosovës për rritjen e pagave në sektorin publik është paralizuar i gjithë sistemi i administratës në gjithë vendin edhe në komunën e Drenasit.

Duke pasur parasysh se shumë qytetarë që jetojnë e veprojnë jashtë vendit, muajt e fundit janë në Kosovë, kryetari Lladrovci, për t'ua lehtësuar marrjen e dokumenteve urgjente të udhëtimit, ka kërkuar nga Sindikata e Pavarur e Administratës së Kosovës gjetjen e një zgjidhje për ofrimin e shërbimeve të kësaj kategorie të qytetarëve jashtë vendit.

Krejt kjo vjen si pasojë e gjendjes kaotike të krijuar nga kërkesat e mëdha të mërgimtarëve tanë, të cilëve po u pamundësohet marrja

e shërbimeve administrative, kryesisht dokumente të udhëtimit për fëmijët e tyre nën moshën 18-vjeçare që atyre u shkakton probleme.

Lladrovci ka theksuar se i përkrah të gjithë punëtorët e administratës publike që kërkojnë trajtim të dinjitetshëm të tyre, por kërkon zgjidhje të kërkesave të tyre në forma që nuk penalizojnë mërgimtarët tanë dhe gjithë qytetarët në përgjithësi.

Dyert e administratës komunale për shërbim të qytetarëve janë të hapura, por Lladrovci ka kërkuar nga kryesia e SPAK-ut në Drenas që secili grevist të vendosë njoftimin në një vend të dukshëm që është në grevë, pasi që pjesëmarrja në grevë është vullnetare dhe kërkon nga qytetarët mirëkuptim për të drejtat e tyre.



## U asfaltuan rrugë dhe rrugica në Lupç, Majac, Popovë dhe Penuhë



**PODUJEVË, 26 GUSHT** - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, i shoqëruar nga drejtori i Planifikimit Urban, Mbrojtjes dhe Mjedisit, Leutrim Krasniqi, ka inspektuar punimet në asfaltimet e rrugëve në fshatrat Lupç i Poshtëm, Majac, Popovë dhe Penuhë.

“Në kuadër të realizimit të investimeve në infrastrukturën rrugore janë duke u realizuar projekte në asfaltimin e rrugëve për të cilat jam i kënaqur me cilësinë dhe dinamikën e punimeve”, ka thënë Bulliqi. Gjatësia e asfaltimit të këtyre rrugëve dhe rrugicave në

këto fshatra është rreth 4 km.

Kryetari Bulliqi i ka uruar banorët e këtyre fshatrave për realizimin e këtyre projekteve si dhe është zotuar për angazhim të mëtutjeshëm për realizim të të gjitha projekteve kapitale të planifikuara për këtë vit.

## Kryetari i Fushë-Kosovës pret në takim drejtorin e Asociacionit të Komunave

**FUSHË-KOSOVË, 26 GUSHT** - Kryetari i komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, ka pritur të premten në një takim pune drejtorin ekzekutiv të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim.

Në këtë takim kryetari Berisha dhe drejtori Ibrahim kanë biseduar për aktualitetet dhe preokupimet

e pushtetit lokal dhe iniciativave ligjore në nivelin qendror të cilat kanë të bëjnë me nivelin lokal.

Drejtori Ibrahim e njoftoi kryetarin Berisha për projektligjet që janë duke u hartuar si Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal, Projektligji për Zyrtarët Publik dhe Projektligji për Pagat.

Kontratave Kolektive dhe problemet që kanë komunat e Kosovës me to mbetet një ndër temat e rëndësishme e cila u diskutua gjatë këtij takimi në mes të kryetarit Berisha dhe drejtorit Ibrahim.

Po në këtë takim është biseduar edhe për çështjet që kanë të bëjnë me Ligjin për Zgjedhjet Lokale.



## Bekim Vishaj dorëzon mandatin e drejtorit të Arsimit në Deçan, Malaj zë vendin e tij

**DEÇAN, 26 GUSHT** - Drejtori i deritanishëm i Drejtorisë së Arsimit në komunën e Deçanit,

Bekim Vishaj, ka dorëzuar mandatin në këtë pozitë dhe në vend të tij kryetari Bashkim

Ramosaj ka emëruar Zeqë Malaj. “Drejtorin Bekim e uruam për përkushtimin dhe punën e

palodhshme gjatë tërë mandatit të tij për ta vazhduar kontributin në fushën e trashëgimisë kulturore,

ndërsa Zeqës i urojmë suksese në pozitën e re”, ka shkruar Ramosaj në “Facebook”.

## Meta drejton akuza në drejtim të Ramës: Kriza në Shqipëri po vazhdon të rëndohet

TIRANË, 26 GUSHT - Kryetari i Partisë së Lirisë, Ilir Meta, ka drejtuar sërish kritika për qeverisjen e Edi Ramës. Ai ka thënë se kriza në Shqipëri po vazhdon të rëndohet jo vetëm për aferën e zezë të inceneratorëve, jo vetëm për supraferën e Portit të Durrësit, kosto e të cilit mund të shkojë deri në 5 miliardë euro për taksapaguesit durrsakë dhe shqiptarë, por edhe për shumë afera të tjera. "Garant dhe përfitues kryesor

i të cilave është Ramoviçi dhe për të cilat do të përgjigjet deri në një", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se përpjekjet e dëshpëruara për të keqpërdorur "krijesat" e partisë në drejtësi për të spostuar vëmendjen e opinionit publik me "hetime" qesharake ndaj drejtuesve të opozitës tregojnë vetëm përpëlitetet e fundit të regjimit kriminal për të shtyrë me ditë

dhe javë llogaridhënien e tij të pashmangshme. "Krijesat e partisë që marrin urdhra në Kongresin e partisë-shtet veç forcojnë bindjen e të gjithë shqiptarëve të ndershëm se janë një seksion i Rilindjes dhe përgjegjëse po sa ajo për korrupsionin galopant dhe lidhjet e krimit me politikën. Monopolin e Drejtësisë e ka vetëm populli i Shqipërisë dhe ai do të jetë gjykatësi më i drejtë shumë shpejt", ka deklaruar Meta.



## Osmani pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i Suedisë, Jonas Westerlund

PRISHTINË, 26 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, të cilin i ka uruar mirëseardhje. Raportet ndërmjet të dy shteteve janë vlerësuar të mira, teksa presidentja Osmani shfaqti besimin se zhvillimet pozitive të raporteve bilaterale ndërmjet Kosovës e Suedisë do të vazhdojnë edhe gjatë mandatit të ambasadorit Westerlund.

Presidentja Osmani ka falënderuar shtetin e Suedisë për ndihmën e deritashme, duke kërkuar që kjo mbështetje të vazhdojë edhe më tej, e sidomos për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në takim është diskutuar edhe për zhvillimet aktuale politike në vend dhe rajon.

Presidentja Osmani ka përsëritur qëndrimin se në dialogun me Serbinë, Kosova është palë konstruktive dhe se ky proces duhet të përqendrohet në njohjen e ndërsjellë. Sipas presidentes Osmani,




vendimet e institucioneve të Kosovës janë në përputhje me marrëveshjet e Brukselit për lirinë e lëvizjes dhe se

institucionet e Kosovës janë në komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë.

Presidentja Osmani dhe ambasadori Westerlund në takim kanë diskutuar edhe për thellimin e raporteve në sferën e

politikës së jashtme, fuqizimin e demokracisë, sundimin e ligjit, barazisë gjinore dhe mbrojtjes së mjedisit.

## Drejtoresha e ShSKUK-së viziton spitalin e Pejës dhe të Gjakovës, njoftohet me kushtet e punës



PEJË, 26 GUSHT - Ushtruesja e detyrës e drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, Pranvera Zejnullahu-Raçi, ka vizituar spitalin e Pejës, atë të Gjakovës dhe Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë. Ajo u njoftua për kushtet e punës, derisa vuri në letër kërkesat e drejtorëve dhe të stafit shëndetësor, të cilat premtori se do t'i trajtojë me

urgjencë. Zejnullahu-Raçi ka thënë se do të përpiqet maksimalisht të gjejë zgjidhje për angazhimin e mjekëve specialistë në repartet ku ndihet mungesa e tyre dhe ku rrezikohet seriozisht ofrimi i shërbimeve shëndetësore. Në përputhje me mundësitë buxhetore, me qëllim që ta ngritë cilësinë dhe t'i aktivizojë shërbimet e reja, Zejnullahu-Raçi, u shpreh se do të bëjë të pamundurën që t'i shtyjë

përpara, gjithashtu, kërkesat për blerjen e pajisjeve të reja. Ushtruesja e detyrës e drejtorit, Pranvera Zejnullahu-Raçi, po zhvillon një tur të vizitave nëpër spitalet e përgjithshme, për ta kuptuar gjendjen e përgjithshme dhe në koordinim me drejtorët e tyre po synon të shtyjë përpara projektet, që në thelb kanë përmirësimin e kushteve në punë dhe rritjen e llogaridhënies.

## Për 24 orë 188 raste të reja me Covid

Prishtinë, 26 gusht - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 972 testimeve,

janë konfirmuar 188 raste të reja me Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Në 24 orët e fundit janë shëruar nga Covid 483 persona. Ndërkaq raste aktive me

këtë virus janë 2 254. Gjatë 24 orëve të fundit vaksinën anti-Covid e kanë marrë 45 persona.





## 15 për qind rritje e pagave në arsim me projektligjin e ri

**PRISHTINË, 26 GUSHT** - Në kohën kur arsimi është në grevë për shkak të kërkesës për mbështetje prej 100 eurosh, Instituti EdGuard ka paraqitur një analizë të pagave sipas Projektligjit të ri të Pagave. Në analizën nga EdGuard rezultojnë një rritje mesatare prej 15% për të gjithë pozitat në arsimin parauniversitar krahasuar me ligjin paraprak të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

“Rritja në paga për mesimdhënësit e arsimit parauniversitar sipas Projektligjit të ri për Paga. Në analizën nga EdGuard rezultojnë një rritje mesatare prej 15% për të gjithë pozitat në arsimin parauniversitar krahasuar me ligjin paraprak të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese”, thuhet në këtë analizë. Projektligji parashihet rritje të mëtejme në pagë sipas

vlerësimit të performancës së mesimdhënësve. “Pagat me rritje të kalkuluar sipas Projektligjit për Paga me koeficient 1-18, me vlerë të koeficientit prej 120 eurosh. Pagat sipas ligjit paraprak të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese të kalkuluar me koeficient 1-10, me vlerë të koeficientit 239 euro”, theksohet në analizën e institutit EdGuard.



**Pagat e mesimdhënëve sipas ligjit të ri për paga\***

Titulli	Paga me rritje	Rritje %
Drejtar të Shkollave të Mesme të Larta	693.10 € +74.90 €	768 € 10.81%
Drejtar të Shkollave Fillore dhe të Mesme të Ulta	645.30 € +98.70 €	744 € 15.30%
Drejtar të Institucioneve Parashkolore	597.50 € +74.50 €	672 € 12.47%
Mësuesdhënës të Shkollave të Mesme të Larta	621.40 € +74.50 €	696 € 12.01%
Mësuesdhënës të Shkollave Fillore dhe të Mesme të Ulta	585.55 € +96.45 €	672 € 14.76%
Mësuesdhënës në Institucioneve Parashkolore	537.75 € +86.25 €	624 € 16.04%
Proçagorët, Prokurorët	549.70 € +134.30 €	684 € 24.43%

# Vazhdohet marrëveshja që mban Kosovën të pavarur nga rrjeti serb i transmisionit të energjisë

**PRISHTINË, 26 GUSHT** - Rrjeti Evropian i Operatorëve të Transmisionit të Energjisë (ENTSO-E) ka vendosur ta vazhdojë marrëveshjen me ndërmarjen KOSTT për vazhdimin e marrëveshjes që e mban Kosovën të pavarur nga rrjeti serb i transmisionit të energjisë. Lajmin e ka bërë me dije kryesuesi i Bordit të

KOSTT-it, Jeton Mehmeti. Në “Facebook” Mehmeti ka thënë se kjo arritje nuk do të ishte e mundur pa përkrahjen e qeverisë dhe miqve tanë ndërkombëtarë. “Pas kalimit të afatit dyvjeçar të marrëveshjes së kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, sot 23 TSO nënshkruese të kësaj marrëveshje pas një

procesi 20 ditorë votuan PRO vazhdimin të saj. Duke konfirmuar edhe një herë se KOSTT sh.a. edhe përkundër të gjitha sfidave me të cilat është ballafaquar gjatë kësaj periudhe ja doli mbanë të jetë i pavarur nga rrjeti interkonektiv i Serbisë dhe partner i besueshëm edhe i fuqishëm në kuadër të

Blokut Energjetik Kosovë Shqipëri. KOSTT është ballafaquar me kriza të mëdha financiare të cilat ishin si rrjedhojë e krizës energjetike gjatë vitit 2021 dhe 2022. Kjo arritje nuk do të ishte e mundur pa përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe miqve tanë ndërkombëtar si:

Ambasadën Amerikane në Kosovë, Ambasadën Gjermane në Kosovë, USAID, KfW si dhe miqtë tjerë ndërkombëtar. Bordi i Drejtorëve të KOSTT falënderon të gjithë punonjësit dhe menaxhmentin e KOSTT për punën dhe përkushtimin”, ka shkruar Mehmeti.



## Parisi dhe Munihi, qytetet me patundshmërinë më të shtrenjtë në Evropë

**PARIS, 26 GUSHT** - Parisi dhe Munihi janë qytetet me patundshmërinë më të shtrenjtë këtë vit në Evropë, sipas grupit Deloitte. Blerësit e një banese të re në Munihi është dashur të paguajnë një mesatare prej 10 500 eurosh për metër katror. Vetëm Parisi ka qenë më i shtrenjtë me 13 462 euro për metër katror. Londra, Osloja dhe Frankfurti kanë qenë më të lira me rreth 8 400 euro në muaj. Në anën tjetër, qytetet bullgare

Varna dhe Burgas në Detin e Zi, kanë pasur banesa të reja me një mesatare prej rreth 900 eurove për metër katror. Ekspertët e Deloitte-s kanë analizuar 68 qytete të mëdha në 23 shtete. Eksperti për patundshmëri, Michael Muller, ka thënë se çmimet e ndërtimit janë rritur në Evropë. Problemet në zinxhirin e furnizimit dhe mungesa e materialeve ndërtuese kanë rritur reziqet në planifikim dhe ekzekutim të projekteve

ndërtuese. Mungesa e stafit dhe inflacioni janë duke rritur çmimet edhe më shumë, ka thënë Muller. Megjithatë, rritja e normave të interesit mund ta ulë kërkesën dhe rritjen e mëtutjeshme të çmimeve. Në shumë qytete evropiane strehimi i refugjatëve nga Ukraina ka prekur tregun e pronave - sidomos në Poloni, Sllovakia dhe Hungari - meqë ka pasur ulje të ofertave për qiradhënie në tremujorin e dytë të vitit 2022.



# Ukraina ka gjetur në Krime ‘Thembrën e Akilit’ të Rosisë



Nga Mark GALEOTTI

Një ditë e re, dhe një tjetër depo armësh ruse e hedhur në erë. Sulmi i fundit, që këtë herë ndodhi në një depo municionesh pranë Majskoje në gadishullin e Krimesë, nxjerr në pah 3 aspekte të veçanta të kësaj faze të luftës, dhe shkallën në të cilën Kiev po i përshtatet asaj më shpejt dhe në një mënyrë efektive se sa Moskë.

E para është që kundërsulmi i ukrainasve i paralajmëruar prej kohësh është deri më tani, më pak një përleshje ballore në terren, dhe më shumë për një përpjekje metodike për të goditur linjat ruse të furnizimit. Deri më tani, kjo ka ndodhur përmes sulmeve me raketa dhe raketa.

Edhe pse nëse është i vërtetë, pretendimi i Moskës se sulmi në Majskoje u krye nga “diversantë”, do të përfaqëson një qasje të re interesante. (Por edhe një siklet për forcat ruse të sigurisë, duke pasur parasysh se autorët e supozuar arritën të zhdukeshin pa lënë gjurmë).

Shprehja e vjetër se “amatorët studiojnë taktikat, ndërsa profesionistët studiojnë logjistikën” është veçanërisht e vërtetë për shkak të varësisë së ushtrive moderne nga furnizimi i vazhdueshëm me karburant, municione dhe të gjitha materialet e tjera që i duhen luftës së mekanizuar.

Për rusët kjo është “Thembra e Akilit”. Pasi ata janë të prirur të mbështeten tek disa qendra furnizimi më të mëdha dhe sa më afër vijës së parë të frontit që jetë e mundur, për të minimizuar distancat që duhet të përshkojë flota e tyre e kufizuar e kamionëve.

Tani që ukrainasit po përdorin jo vetëm raketa-hedhësit e rinj amerikanë HIMARS me raketat GMLRS shumë të sakta, por edhe një sërë sistemesh të tjera artilerie dhe raketash të dërguara nga NATO, pretendimi i Kievit se mund të godasë mjaftueshëm të gjitha linjat e furnizimit të Rosisë në jug, është më se i besueshëm.

Me shkatërrimin e dhjetëra rezervave të karburantit dhe municioneve, rusët duhet të

mbështeten tani tek rezerva shumë më të vogla dhe më larg vijës së frontit. Kjo nuk është arsyeja e vetme pse javët e fundit kanë sjellë një rënie dramatike të sasisë së zjarrit të artilerisë në vijën e frontit, por sigurisht që është një nga kryesoret.

Meqë rusët janë mbështetur tek bombardimet masive për përparimet që kanë bërë, kjo e degradon seriozisht aftësitë e tyre sulmuese, si dhe aftësinë e tyre për të ndalur çdo kundërsulm të ukrainasve.

E dyta është se sa saktësia e sistemeve të armëve perëndimore që i janë dërguar Ukrainës, po përdoret më së miri falë të dhënave të sakta të shërbimeve sekrete, gjë që lejon shënjestrimin e shpejtë apo edhe në kohë reale. Në disa raste, duket se kjo është falë ndihmës perëndimore, me informacione nga satelitët spiunë dhe mbledhjen e inteligjencës teknike që i dërgohet në fshehtësi Kievit.

Pastaj është përdorimi i mirë i dronëve, skautëve të fshehtë në terren, apo informatorëve në

mesin e popullatës që tani qëndron prapa vijës së frontit në zonën tashmë të pushtuar nga rusët. Pavarësisht përpjekjeve për të konfiskuar telefonat celularë të ushtarëve të tyre, dhe për të parandaluar rrjedhjen e informacionit të zbatueshëm, rusët po “notojnë kundër rrymës”.

Për shembull, një sulm raketor i kohëve të fundit mbi një seli të forcës mercenare Wagner në Popasna, u krye falë postimit të pakujdesshëm në mediat sociale të një gazetari pro-rus. Kur ai ngarkoi në Telegram një foto që tregonte bazën dhe një shenjë në rrugë, ai u dha pa dashje ukrainasve të dhëna për të identifikuar vendndodhjen e saj, në mënyrë që mund të shënjestrohej duke përdorur koordinatat GPS.

Së fundmi, sulmi nënvizon mesazhin që përçoi sulmi i javës së kaluar në bazën ajrore Saki: se Krimea është vërtetë në lojë në këtë luftë. Sigurisht, nuk ka të ngjarë të shohim se shpejti një sulm të drejtpërdrejtë ukrainas ndaj gadishullit të mbrojtur shumë rëndë.

Por paprekshëmeria e tij relative – për shkak të bazave, aeroporteve dhe qendrave të shumta furnizimit – që gëzonte deri disa ditë më parë është tashmë një gjë që i përket së kaluarës. Nga ana tjetër, asnjë nga këto zhvillime surprizuese nuk sugjeron se është e pashmangshme një fitore e Ukrainës.

Është gjithmonë e rrezikshme që Rusia të konsiderohet e humbur. Por këto sulme nënvizojnë shkallën e madhe në të cilën ukrainasit po përshtaten më shpejt dhe më efektivisht se armiku i tyre, duke marrë sasi të mëdha ndihme ushtarake perëndimore dhe duke e përdorur atë në mënyra që maksimizojnë forcat e tyre, dhe ua mohojnë rusëve shfaqjen e forcës së tyre.

Kjo nuk është vetëm një çështje e numrit të madh të ushtarëve apo peshës së bombardimeve, madje as e taktikave dhe cilësisë së komandës. Është një luftë e imagjinatës dhe përshtatjes, dhe këtu ukrainasit kanë demonstruar sërish avantazhin e tyre. / “Spectator” – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Ballkani mëson kundërshtarët në Ligën e Konferencës

Klubi i futbollit nga Suhareka, Ballkani, ka shkruar historinë në futbollin vendor, duke fituar titullin e kampionit, por ka shkëlqyer edhe në arenën ndërkombëtare, duke u bërë klubi i parë nga Kosova që siguron kualifikimin në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës. Të premten ky klub ka mësuar edhe kundërshtarët në këtë fazë e që janë Slavia Praha, CFR Cluj dhe Sivasspori

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

Prishtinë, 26 gusht - Në Stamboll të Turqisë është tërhequr shorti për fazën e grupeve të Ligës së Konferencës. Kampioni i Kosovës, Ballkani, që për herë të parë arriti një sukses historik duke e siguruar këtë fazë, ka mësuar emrat e kundërshtarëve në fazën e grupeve. Ballkani bën pjesë në grupin Grupi G së bashku me Slavia Praha, CFR Cluj dhe Sivassporin. Të pranishëm në tërheqje të shortit ishin edhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi si dhe përfaqësuesi i FC Ballkani, Nderim Nexhipi. Ndeshjen e parë në kuadër të fazës së grupeve Ballkani e luan më 8 shtator, ndërsa programi i ndeshjeve vazhdon më 15 shtator, 6 tetor, 13 tetor, 27 tetor dhe 3 nëntor. Fituesit e tetë grupeve kalojnë direkt në fazën e 1/16 së finale, derisa skuadrat e vendit të dytë në tetë grupet luajnë



në "play-off" me tetë skuadrat e vendit të tretë në grupet e Ligës së Evropës. Shtëpia Evropiane e Futbollit, UEFA, i ka kushtuar një shkrim suksesit të madh të Ballkanit në Ligën e Konferencës. "Ballkani u bë skuadra e parë nga Kosova që u kualifikua në fazën e grupeve të një kompeticioni të madh të klubeve të UEFA-s", ka shkruar UEFA. Fazat e grupeve të tri garave kryesore të UEFA-s për klube për

meshkuj - UEFA Champions League, UEFA Europa League dhe UEFA Europa Conference League - do të jenë një nga më gjithëpërfshirëset deri më tani. Pothuajse dy të tretat e shoqatave anëtare të UEFA-s do të përfaqësohen (36 nga 55) dhe do të luajnë të paktën gjashtë ndeshje kundër skuadrave nga i gjithë kontinenti. "Klubet nga Kosova, Lituania dhe Lihtenshtajni, do të përjetojnë për herë të parë fazën e

GRUPI A	GRUPI E
Istanbul Bashakshir Fiorentina Hearts RFS	Alkmaar Apollon Vaduz Dnipro
GRUPI B	GRUPI F
West Ham United Steava e Bukureshtit Anderlecht Silkeborg	Gent Molde Shamrock Rovers Djurgardens
GRUPI C	GRUPI G
Villareal Hapoel Beer-Sheva Austria Wien Lech	Slavia Praha CFR Cluj Sivasspor Ballkani
GRUPI D	GRUPI H
Partizan Kohn Nice Slovakia	FC Basel Slovan Bratislava Zalgris Pyunik

grupeve të një gare të madhe klubesh të UEFA-s - gjë që mund të ndihmojë vetëm në rritjen e shikueshmërisë së futbollit në këto vende. Krijimi i Ligës së Konferencës së Evropës ka qenë vendimtar për këtë zhvillim. Përveç që u jep më shumë lojtarëve

mundësinë për ta përjetuar futbollin evropian, gjë që do t'i ndihmojë në zhvillimin e karrierës së tyre, kompeticioni u ka dhënë gjithashtu klubeve dhe tifozëve të tyre mundësinë të ëndërrojnë për të fituar një trofe evropian", ka vazhduar shkrimi i UEFA-s.

## 'IHF Trophy' sërish në Kosovë

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kosova do të jetë sërish qendër e rëndësishme e hendbollit. Prej 10 deri më 16 tetor në Prishtinë do të organizohet gara "IHF Trophy" për zonën e Evropës. Ky kompeticion me peshë, në kryeqendrën e Kosovës, do të organizohet për grupmoshën e juniorëve dhe të rinjve. Është ky një tjetër sukses i Federatës së Hendbollit të Kosovës. "IHF Trophy" është garë e Federatës Ndërkombëtare të Hendbollit që ia ka dhënë FHK-



së të drejtën e organizimit të ngjarjes së rëndësishme. FHK-ja deri më tani ka organizuar shumë ngjarje të hendbollit, duke përfshirë edhe "IHF Trophy" dhe vazhdimisht është

konfirmuar si nikoqire shembullore. Për këtë arsye, IHF-ja sërish ia ka besuar Kosovës organizimin e "IHF Trophy" për zonën evropiane. Në këtë garë me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të hendbollit janë ftuar ekipet kombëtare të Shqipërisë, Andorrës, Armenisë, Azerbajxhanit, Bullgarisë, Britanisë së Madhe, Gjeorgjisë, Irlandës, Moldavisë dhe Maltës. Shumica prej tyre pritet të marrin pjesë. Edhe për kombëtares tona kjo garë është me rëndësi, marrë

për bazë shkëputjen që ka ndodhur për shkak të pandemisë. Në fakt, ekipet tona kombëtare paraqiten rregullisht në kampionate evropiane, por një kampionat shtesë do të jetë i mirëseardhur për hendbollistët tanë të rinj. Kosova natyrisht e synon suksesin në "IHF Trophy" për Evropë. Fituesi i "IHF Trophy" për juniorët dhe për të rinjtë kualifikohet në fazën interkontinentale. Ndërkohë fituesi i fazës interkontinentale

siguron biletën për në Botëror. Përmes kësaj gare Kosova U21 vite më parë luajti në Botërorin në Spanjë, duke shkruar histori. Te juniorët luajnë lojtarët e lindur në vitin 2002 dhe më të rinj. Ndërkohë te të rinjtë (youth) luajnë lojtarët e lindur në vitin 2004 dhe më të rinj. Këto grupmosha të Kosovës këtë verë e kanë paraqitur Kosovën në kampionate evropiane. Rezultatet nuk ishin ato që synoheshin, por dukshëm më tepër synohet në "IHF Trophy".

## Thaqi: Kosova është atdheu ynë, ishte nder ta përfaqësoja

PRISHTINË, 26 GUSHT - Edona Thaqi këtë vit ishte bashkuar për herë të parë me Përfaqësuesen A të femrave në ndeshjet që Kosova i zhvilloi në kuadër të FIBA Kampionatit Evropian të shteteve të vogla. Në një intervistë për faqen zyrtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës ajo ka folur për debutimin me Kosovën, mikpritjen ndaj saj dhe mesazhin për femrat që duan t'u bashkohen "dardaneve". "Krahas shtetësisë sime amerikane, jam rritur me njohuri të thella, mirënjohje dhe pasion për rënjtë e mia shqiptare. Ishte

nder që pata mundësinë ta përfaqësoja Kosovën. Basketbolli ka qenë gjithmonë një pjesë kryesore e jetës sime dhe të jem në gjendje të luaj Kosovën do të thotë shumë për mua dhe familjen time. Është diçka që nuk do ta harroj kurrë", është shprehur ajo, duke shtuar: "Momentet më të mira ishin pa dyshim fitoret. Ne të gjitha e dhamë më të mirën e mundshme në çdo lojë". Edona ka folur edhe rreth atmosferës dhe mikpritjes nga vajzat dhe stafi i Përfaqësueses së Kosovës. "Jam pritur vërtet krahëhapur nga

vajzat, trajnerët dhe nga të gjithë anëtarët e Federatës së Basketbollit të Kosovës. U ndjeva shumë rehat menjëherë dhe isha në gjendje të ndërtoja një lidhje me vajzat. Kur keni një respekt të ndërsjellë për njëri-tjetrin, është disi e lehtë të lidheni mes vete, veçanërisht kur jemi në ndeshje". Gjatë qëndrimit në Kosovë ajo ishte takuar edhe me kryeministrin e Kosovës. "Ishte një privilegj të takohesha me kryeministrin Albin Kurti. Jam shumë mirënjohëse që arrita të ndaj shpresat dhe ëndrrat e mia për t'i fuqizuar sportistet, duke

përdorur basketbollin si një mjet për t'i ndihmuar fëmijët t'i zhvillojnë aftësitë e tyre, dashurinë për lojën dhe aftësinë për të ëndërruar për një të ardhme më të ndritshme. Ai ishte vërtet përkrahës për Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe na uroi fat në ndeshjet e garave ndërkombëtare". Në fund Thaqi ka një mesazh për të gjithë femrat që duan t'i bashkohen përfaqësimit të Kosovës. "Mesazhi im për të gjitha sportistet që kanë rënë shqiptare në mbarë botën është të stërviteni sipas aspiratave tuaja



dhe mos keni frikë të ëndërroni të mëdha. Ju mund të bëni gjithçka që keni në mendje për sa kohë që punoni shumë. Nuk duhet të hezitoni ta përfaqësoni Kosovën nëse ju jepet mundësia sepse Kosova është atdheu ynë. Të gjithë duhet të përpiqemi të jemi ambasadorë të mëdhenj për vendin tonë dhe kombëtares në tërësi", ka përfunduar Thaqi.

## Bleart Tolaj, 'ylli i javës' në Superligë

Prishtinë, 26 gusht - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "ylli i javës". Këtë javë ky çmim i është dhënë futbollistit të FC Malisheva, Bleart Tolaj. Tolaj ishte më i

merituari për fitoren që FC Malisheva e arriti kundër Ferizajt me rezultat 3-1. Përveç golit të shënuar në minutën e 77, ai, gjithashtu, gjatë tërë ndeshjes ishte protagonist kryesor në lojë dhe kreator i disa rasteve të tjera. "Ndihem

shumë mirë për këtë vlerësim dhe dua ta falënderoj stafin teknik dhe bashkëlojtarët e skuadrës, pa të cilët sigurisht se nuk do të mund ta fitoja këtë çmim. Shpresoj që ky të mos jetë çmimi im i fundit në këtë edicion. Synimet e

Malishevës janë të qarta. Shpresojmë në rezultate të mira në vazhdim të kampionatit dhe të përfundojmë në pjesën e epërme të tabelës dhe, pse jo, edhe të jemi pjesë e garave evropiane", ka thënë Tolaj.



## Marku: I lumtur për fitoren, por jo për performancën

TRANË, 26 GUSHT - Florian Marku arriti të gëzojë mijëra shqiptarë që ishin në stadium dhe të tjerë që e shihnin duelin në ekran. Triumfi në "Air Albania" i ka rritur shanset 29-vjeçarit që të ngjitet në elitën e boksit profesionist. Në intervistën për ABC, Florian Marku u shpreh mjaft i lumtur për fitoren, por jo për performancën. "Jam i lumtur për fitoren, por jo me performancën time. Ai u shpreh se një përplasje me kundërshtarit i vuri në rrezik fitoren". Marku fitoi me pikë ndaj rivalit meksikan Parra, ndërsa shqiptari pranoi se e priste një ndeshje kaq të luftuar. "E prisja një ndeshje të luftuar sepse meksikanët janë të fortë si dhe janë guximtarë, nuk dinë të dorëzohen. Siç e patë, meksikani luftoi deri në momentin e fundit dhe nuk u dorëzua".

Mbështetja e tifozëve në "Air Albania" i dha Markut mjaft motivim. Ai u shpreh për ABC se e kishte një detyrim fitoren, jo vetëm



për vijueshmërinë në karrierën e tij, por edhe një detyrim moral për shqiptarët që ishin të shumtë në stadium.

Florian Marku theksoi se ky nuk do të jetë dueli i fundit në Shqipëri,

ndërsa premtoi se çdo vit do të zhvillojë një ndeshje përpara bashkëkombësve të tij. "Gjatë këtij viti do të zhvilloj edhe dy ndeshje të tjera. Çdo vit kam dëshirë që të bëj ndeshje në Shqipëri", tregoi ai.

## Tërhiqet shorti i Ligës së Evropës

Stamboll, 26 gusht - Janë mësuar edhe tetë grupet e Ligës së Evropës për sezonin e ri. Pretendentët kryesorë kanë rënë në grupe jo të vështira dhe nuk pritet të ketë surpriza për avancuar më tej. Shorti ka qenë i mëshirshëm për skuadrat e mëdha që marrin pjesë në këtë kompeticion si Manchester United, Arsenal, Lazio dhe Roma. Unitedi është në grup me Real Sociedadin, Sherifin, Omonoian. Arsenali ka punë me PSV-në, Bodo/Glimt dhe Zurich.



### GRUPET E LIGËS SË EVROPËS

- Grupi A: Arsenal, PSV Eindhoven, Bodo/Glimt, Zurich
- Grupi B: Dynamo Kyiv, Rennes, Fenerbahçe, AEK Larnaca
- Grupi C: Roma, Ludogorets, Real Betis, HJK Helsinki
- Grupi D: BRAGA, Malmo, Union Berlin, Saint-Gilloise
- Grupi E: Man. United, R. Sociedad, Sheriff, Omonoia
- Grupi F: Lazio, Feyenoord, Midtjylland, Sturm Graz
- Grupi G: Olympiacos, Qarabag, Freiburg, Nantes
- Grupi H: Crvena zvezda, Monaco, Ferencvaros, Trabzomspor

## Inzaghi: Ne jemi Interi dhe e përballojmë çdo kundërshtar

Interi është në grupin e "vdekjes" në Ligën e Kampionëve ku në grupin C duhet t'i matin forcat me Bayern Munchen, Barcelonën dhe Viktoria Plzenit. Trajneri Simone Inzaghi e ka cilësuar si grup i hekurt por, ndër të tjera, është shprehur se janë Interi dhe do të përballojnë

çdo kundërshtar. "Kemi përballë skuadra shumë të forta dhe të organizuara mirë, por në këto nivele lojërë të lehta dhe të parashikueshme nuk ekzistojnë. Në Ligën e Kampionëve të kaluarën Interi kaloi në turin e dytë. Synimi ynë është t'i japim vazhdimësi asaj që nisi vitin e

kaluar. Liga e Kampionëve është një kompeticion shumë prestigjioz. Si gjithmonë do të përgatisim çdo detaj për të qenë plotësisht të përgatitur në çdo ndeshje. Ne jemi Interi dhe e përballojmë konkurrencën me entuziazëm", ka thënë Inzaghi.

### SHKURT

#### Muller: Zoti Lewandowski, shihemi së shpejti

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Thomas Muller, e ka komentuar shortin e Ligës së Kampionëve ku klubi gjerman do ta ketë përballë Barcelonën, Interin dhe Viktoria Plzen. Sulmuesi gjerman mezi po e pret përballjen me ish-shokun e skuadrës, Robert Lewandowski. "Çfarë shorti i bukur për tifozët! Zoti Lewandowski, shihemi së shpejti në Munchen! Sa bukur që do të takohemi me Barcelonën dhe Lewandowskin. Për mua është një grup i madh me skuadra të mëdha. Do të jenë mbrëmje të bukura të Ligës së Kampionëve për tifozët e futbollit. Por një gjë është e qartë: duhet të bëjmë detyrat për t'u kualifikuar në 1/8-at", ka thënë Muller.

#### Leclerc starton i fundit në garën e Belgjikës

Charles Leclerc do ta nisë garën e Çmimit të Madh të Belgjikës nga vendi i fundit. Ferrari ka vendosur të montojë në makinën e pilotit monogask një motor të ri, që do të ketë edhe një sistem hibrid të ri, që do t'i japë më shumë fuqi njëvendëshe së tij. Kjo masë u mor për të pasur një makinë më të fuqishme në tri garat që do të zhvillohen njëra pas tjetrës: Belgjikë, Holandë e Itali. Drejtuesit e "kokëkuqes" vendosën që të sakrifikojnë garën e Belgjikës, që ka një pistë të gjatë e ku ka shumë mundësi për parakalime. Për Leclerc një garë e vështirë, pasi do ta nisë nga vendi i fundit, ndaj shanset për fitore janë të palta. Ai që do të synojë të mbajë lart "Flamurin" e Ferrari është spanjoli Carlos Sainz. Te Ferrari, në këtë garë do të montohet edhe një pjesë e pasme e modifikuar, për të garantuar më shumë ngarkesë aerodinamike.

#### Ronaldo, afër marrëveshjes me Napolin

Cristiano Ronaldo i është ofruar Napolit nga Manchester United. "Djajtë e kuq" duan Victor Osimhen, për të cilin janë gati të paguajnë 100 milionë euro dhe të japin në huazim portugezin për një sezon. Anglezët janë të gatshëm të paguajnë pjesën më të madhe të pagës së Ronaldos dhe presidenti i Napolit e ka miratuar në parim këtë lëvizje. Tashmë po bisedohet me Jorge Mendes për detajet, që të bëhet fakt i kryer kalimi i Ronaldos te Napoli dhe shitja e Osimhen te Manchester United.

#### Gjokoviqi mungon në US Open, shkak mosvaksinimi

Tenisti serb Novak Djokoviq, ish-numri 1 në botë dhe fitues i 21 grand slam, nuk do të luajë në turneun e US Open, që nis më 29 gusht në Nju Jork. Shkak është mosvaksinimi i tenistit serb, që nuk mund të udhëtojë drejt Amerikës, për shkak të ligjeve në fuqi Lajmin e konfirmuan organizatorët e US Open. Gjithashtu edhe vetë tenisti ka deklaruar në rrjetet sociale pak më parë se nuk mund të niset për në Amerikë, pasi është i pavaksinuar. Për serbin ky është grand slam i dytë këtë vit që nuk luan për shkak se nuk pranon të kryejë vaksinën anti-Covid, pas atij të Australian Open (në janar). Edhe pse shkoi në Melburn, ai humbi betejën ligjore me qeverinë dhe u detyrua të rikthehet në vendlindje. "Për fat të keq, nuk mund të udhëtoj në Nju Jork për të luajtur në US Open. Falënderoj të gjithë fansat për mbështetjen. U uroj fat miqve të mi tenistë! Jam në formë dhe pozitiv shpirtërisht, duke pritur për një mundësi që të luaj sërish. Do të shihemi së shpejti", ka shkruar Djokoviq.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2, dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 01.12.2010, lidhur me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores me nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., në Vushtrri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtrri, e duke u bazuar në vendimin me nr. 908/22 të datës 25.08.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 25.08.2022 shpall:

### KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendeve të lira të punës "Pastrues të Zyrave dhe Objekteve", "Depoist" dhe "Sigurim Fizik")

- I. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve  
Numri i ekzekutuesve: 4  
Orët e punës: 40 orë në javë  
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.  
Përgatitja profesionale: Shkolla fillore  
Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune  
I raporton: Udhëheqësit të njësisë së mirëmbajtjes-pastrimit të zyrave dhe objekteve  
Koeficienti i pagës: Sipas aktit të brendshëm të Ndërmarrjes.

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësisë së Mirëmbajtjes-Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);.

- II. Titulli: Depoist  
Numri i ekzekutuesve: 1  
Orët e punës: 40 orë në javë  
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi  
Përgatitja profesionale: Bachelor apo Shkolla e mesme (Shkolla e mesme Ekonomike, Gjimnazi i Përgjithshëm etj.).  
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj  
I raporton: Mbikëqyrësit të Depos  
Kushtet e veçanta: Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë fizike e preferuar  
Koeficienti i pagës: Sipas aktit të brendshëm të Ndërmarrjes.

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Pranon në depo materialin, mjetet e punës dhe veglat e punës, si dhe inventarin e nevojshëm për punën e ndërmarrjes;
- Sipas kërkesave dhe urdhërave të punëtorëve e jep materialin, mjetet dhe veglat e punës;

- Mban evidencën e rregullt të stoqeve në depo dhe e dorëzon raportin;
- Pranon, regjistron dhe mban evidenca lidhur me asetet e ndërmarrjes;
- Mban evidencën e ngarkesës me vegla të punës dhe mjeteve të punës nga ana e punëtorëve;
- Në rastin e pranimit dhe dhënies së materialit, veglave etj., përkujdeset për cilësi dhe sasinë e materialit të pranuar, të dorëzuar dhe të kthyer;
- Mban me rregull kartelat e materialit;
- Përgatitë të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e depos, dhe është i obliguar të jetë prezent gjatë punës së komisionit për inventarizim;
- Kryen edhe punët tjera që i përkasin profesionit, dhe në bazë të urdhërësës së mbikëqyrësit të depos dhe ZKF në pajtim me ligjin.
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A. - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);.

- III. Titulli: Sigurim Fizik  
Numri i ekzekutuesve: 2  
Orët e punës: 40 orë në javë  
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi  
Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme  
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj  
I raporton: Udhëheqësit të njësisë së Sigurimit Fizik  
Kushtet e veçanta: Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë fizike e preferuar  
Koeficienti i pagës: Sipas aktit të brendshëm të Ndërmarrjes.

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që kryen i përgjigjet udhëheqësit të njësisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A. - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);.

#### Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrat e N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 26.08.2022 deri me datë 09.09.2022 në ora 16:00.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr.tel. 044 - 732 - 058.

**Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.**



Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, i člana 11, člana 21. pod st. 2.2 i člana 25 Uredbe 55/21 o radnim odnosima NPL „Përparimi“ Š. A. u Vuçitru odobreno 21.12.2021, a na osnovu odluke br. 908/22 od 25.08.2022, godine glavnog izvršnog direktora N.P.L. „Përparimi“ Š. A od 25.08.2022 saopštava:

### JAVNI KONKURS

(Za popunu radnih mesta „Čistač kancelarija i objekata“, „magacioner“  
„Fizičko obezbeđenje“)

- I. Naslov: Čistač kancelarija i objekata  
Broj izvršilaca: 4  
Radno vreme: 40 sati nedeljno  
Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja  
Stručna priprema: Osnovna škola  
Radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo  
Izveštava: Rukovodioci jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata  
Koeficijent plate: Prema internom aktu Preduzeća.

#### Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od pretpostavljenog;
- Pridržiće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i druge obaveze vezane za radno mesto a na osnovu zahteva pretpostavljenog
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

#### Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za NPL „Përparimi“ Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Dokaz o radnom iskustvu (ako postoji, nije obavezan);
- Kopija lične karte;
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i mora se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci);

#### II. Naslov: Magacioner

Broj izvršilaca: 1  
Radno vreme: 40 sati nedeljno  
Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja  
Stručna priprema: Osnovna škola  
Radno iskustvo: Poželjno je šest (6) meseci  
Posebni uslovi: Nadzornici skladišta  
Koeficijent plate: Prema internom aktu Preduzeća.

#### Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- prima u magacinu materijal, radni alat i radni alat, kao i inventar neophodan za rad preduzeća;
- Po zahtevima i nalogima radnika daje materijal, alat i radni alat;
- Vodi redovnu evidenciju zaliha u magacinu i podnosi izveštaj;
- Prihvata, registruje i vodi evidenciju u vezi sa imovinom preduzeća;
- Vodi evidenciju o opterećenju radnih alata i alata za rad od strane radnika;
- U slučaju prihvatanja i davanja materijala, alata i sl. vodi se računa o kvalitetu i količini primljenog, dostavljenog i vraćenog materijala;
- Održava materijalne kartice u redu;

- Pripremi potrebne podatke i dokumentaciju za registraciju magacina, i dužan je da prisustvuje radu popisne komisije;
- Obavlja i druge poslove koji pripadaju struci, a po nalogu nadzornika skladišta i finansijskog direktora u skladu sa zakonom;
- obavlja i druge poslove na osnovu naloga rukovodstva preduzeća;

#### Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za NPL „Përparimi“ Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i mora se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci);

#### III. Naslov: Fizičko osiguranje

Broj izvršilaca: 2  
Radno vreme: 40 sati nedeljno  
Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja  
Stručna priprema: Srednja škola  
Radno iskustvo: Poželjno je šest (6) meseci  
Izveštava: Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje  
Posebni uslovi: Fizičke sposobnosti, poželjno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite  
Koeficijent plate: Prema internom aktu Preduzeća.

#### Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavestiti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sredstva zaštite na radu;
- Umeti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, mozetetakođe je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

#### Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za NPL „Përparimi“ Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i mora se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci);

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu primiti i predati prijavi formular u kancelarijama NPL „Përparimi“ Š. A u gradu Vuçitru, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vuçitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 26.08.2022 do 09.09.2022 u 16:00 časova.

N.P.L. "Peparimi" Š. A u Vuçitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 732 - 058.

**Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, dok će nepotpune prijave biti odbijene.**



Adresa: Rr. "Tahir Zajmi", nr. 5, p.n., Prishtinë  
Tel: +383 (0) 38 603 191; 0800 77123  
e-mail: <http://pastrimi.info>; [info@pastrimi.org](mailto:info@pastrimi.org)

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, shpall:

## KONKURS

**Titulli i pozitës:** Këshilltar të Kryeshefit Ekzekutiv – 1 pozitë

**Institucioni:** Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

**Titulli i Mbikëqyrësit/Raporton tek:** Kryeshefi Ekzekutiv (KE)

**Orari i Punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** me afat të caktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Shqyrton propozimet e politikës afariste para aprovimit të tyre, jep mendimet dhe sygjerimet e tij lidhur me të;
- Shqyrton propozimin e organizimit të ndërmarrjes dhe raportet për rezultatet e punës në ndërmarrje, jep propozime dhe sygjerime për organizim më të mirë të veprimtarisë dhe përcjell dukuritë e afarizimit dhe propozon masa për rritjen e shfrytëzimit të mekanizmit teknik në funksion të ngritjes së kualitetit të shërbimeve;
- Siguron dhe mbikëqyr koordinimin e punëve ndërmjet Shërbimit të Operativës dhe Shërbimit Financiar (Shërbimit me klientë);
- Propozon masa për përparimin e organizimit të punës;
- Koordinon dhe bashkëpunon me organizatorët e procesit të punës në të gjitha sektoret dhe njësitë punuese;
- Propozon marrjen e masave që mund të merren ndaj sektorëve apo njësisë punuese ku ka çrregullime në punë dhe organizim të punës;
- Kryen dhe punë të tjera sipas nevojës.

**Shkathtësitë e kërkuara:** (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri të thellë profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve ligjore;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi udhëheqëse, ndërpersonale si dhe pune në grup;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Ëord, Exel, etj).

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës:** (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën juridike.

**Konkursi është publikuar më datë 26 gusht 2022 dhe mbyllet më datë 10 shtator 2022**

**APLIKACIONI:** Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. CV-ja e kandidatit;
3. Kopja e diplomës;
4. Dëshmitë për përvojën e punës (kontrata e punës);
5. Certifikata që nuk jeni nën hetime.

### MËNYRA E APLIKIMIT:

Kërkesat dorëzohen në zyrën nr. 8 të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, Rr. "Tahir Zajmi". Nr. 5

### VËREJTJE:

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë  
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672  
e-mail: [mirembajfia@npbanesore.com](mailto:mirembajfia@npbanesore.com); [info@npbanesore.com](mailto:info@npbanesore.com)

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

## KONKURS

*Për plotësimin e vendit të punës*

**Titulli:** Zyrtar/e në qendren e thirrjeve - 3 (tri) pozita

**Nr. i referencës:** NPB/DSHK/ 10.6

**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit për Menaxhim të Llogarive dhe Kontratave

**Niveli i pagës:** 6

**Orët e Punës:** 40 orë në javë (me ndërrime)

**Kohëzgjatja e kontratës:** Për periudhë të caktuar 1 vjeçare (puna provuese deri në 3 muaj)

**Vendi i punës:** Rr."Zija Shemsiu" nr.22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- a) Pranon telefonatat dhe drejton ato në mënyrë efikase;
- b) Është përgjegjës për regjistrimin dhe evidentimin e të gjitha kërkesave që vinë nga Qendra e Thirrjes;
- c) Hap dhe menaxhon procedurat e urdhëresave të punës;
- d) Koordinon takimet në mes punonjësve të terrenit me palët e treta;
- e) Është përgjegjës për ofrimin e informatave dhe formularëve përkatës në lidhje me proceset e punës në Departamentin e Komunikimit dhe Mediave;
- f) Mban shënime të detajuara për të gjitha llojet e kërkesave dhe i delegon ato tek personat përgjegjës;
- g) Organizon takime në mes të Divizionit dhe palëve për çështjet që kanë të bëjnë me shërbime Administrative;
- h) Mban shënime për korrespondencat me palët si dhe i njofton palët lidhur me procedurat që duhet ndjekur për rimëzimin e kërkesave apo të shërbimeve që kanë të bëjnë me NPB;
- i) Përgatit materialin logjistik të nevojshëm për punët e Divizionit për Menaxhim të Llogarive dhe Kontratave dhe të Departamentit të DKM-së në përgjithësi;

**Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:**

- f) Udhëheqësi i Divizionit për Menaxhim të Llogarive dhe Kontratave e ngarkon me detyra tjera sipas nevojës së NPB-së;
- g) Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhër të menaxhmentit mund ta zëvendësojë dhe të kryej detyrat tjera.

**Kualifikimet:**

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Dëshmi për përvojë pune së paku 1 vit.

**Aftësitë:**

- Aftësi kompjuterike në gjithë aplikacionet e MC Office;
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe negociuese;
- Aftësi të larta të evidentimit dhe sistemimit të dokumentacionit;
- Në gjendje për të punuar nën presion dhe me orar të zgjatur;
- Njohja e gjuhës Angleze;
- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Shkathtësi të shkëlqyera komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathtësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;

**Kualifikimet e preferueshme:**

- Kurset dhe trajnimet tjera gjate karrierës profesionale;
- Patent shofer kategoria-B.

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: [www.npbanesore.com/shpalljet/mundesit-punesimi/](http://www.npbanesore.com/shpalljet/mundesit-punesimi/). Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, ose të aplikojnë përmes emailit zyrtar: [burimet.njerezore@npbanesore.com](mailto:burimet.njerezore@npbanesore.com) apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

**Dokumentet që duhet të bashkëngjiten:**

- Aplikacioni i NPB-së;
- Dëshmitë për Shkollën e Mesme;
- Dëshmitë për përvojën e punës së paku 1 vite;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

**Shënim:** Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.**

**Shpallja është e hapur që nga data 26.08.2022 deri më 09.09.2022**

**Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të nenit 18 dhe 22 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në bazë të Aktgjykimit nr. Ref. AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

**KONKURS**  
**PËR PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR**

**I. Zyrtar për Buxhet dhe Financa**

Prokuroria Themelore Prizren, një (1) pozitë, për nëntë (9) muaj

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 015  
Emri pozitës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa  
Pozita: Pozitë jo e karrierës  
Niveli: Profesional  
Kodi punës: BF/210  
Raporton tek: Administratori i Prokurorisë  
Numri i pozitave: Një (1) pozitë  
Koeficienti: Shtatë (7)  
Akti i emërimit: Me afat të caktuar  
Puna Provuase: Tre (3) muaj  
Vendi: Prizren

**Qëllimi i vendit të punës:**

Zyrtari Financiar brenda njësisë organizative planifikon nevojat buxhetore, kontrollon rregullsinë e faturave, përditëson të dhënat në sistemin e pagesave për avokatë dhe ekspertë, mban evidencën e faturave si dhe sigurohet që dorëzimi i faturave të bëhet brenda afateve ligjore.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

Në konsultim me administratorin dhe kryeprokurorin përgatit nevojat për rishikim të buxhetit, nevojat buxhetore për vitin e ardhshëm dhe planifikimet e hershme për 2 vitet në vijim.

Sigurohet që faturat brenda njësisë organizative janë të rregullta, të sakta, dhe të plota dhe mban evidencën e faturave dhe sigurohet që të mos ketë përsëritje të faturave dhe të jone brenda afateve ligjore.

Regjistron dhe përditëson sistemin e pagesave për avokatë dhe ekspertë.

Sigurohet që kërkesat për para të imta (petty cash) të jenë bazuar në ligj dhe përgatit kërkesat respektive.

Përgatitja e kërkesave për mëditje dhe avanse për të gjithë personelin e njësisë organizative.

Përgatit urdhër blerjet, kërkesat për zotime dhe shlyerje të obligimeve për të gjitha faturat e njësisë organizative si dhe sigurohet që të gjitha të jenë të nënshkruara nga zyrtarët autorizues.

Harton raporte të rregullta dhe ad hoc për gjendjen e faturave në njësinë organizative dhe njësinë qendrore

organizative dhe raporton në baza të rregullta për obligimet e faturave të papaguara në njësinë qendrore organizative.

Përgatit plan të punës në përputhje me ligjin, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara.

Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me legjislacionin ne fuqi të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe sipas kërkesës së Zyrtarit Kryesor Financiar dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë;

**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**

Njohuri të shkëlqyera profesionale nga lëmin e financave publike;

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale lidhur me financat;

Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Access, Power Point) dhe internetin;

Shkathtësi të punojë në mjedis shumetnik dhe për punë ekipore;

Shkathtësi për të caktuar synimet më të rëndësishme dhe dhëna e prioriteteve atyre;

Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;

Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion;

**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**

Diplomë Universitare Fakulteti Ekonomik.

**Përvoja e Punës:**

Dy (2) vite përvojë pune profesionale.

- Shpallja e Konkursit është e hapur 8 ditë kalendrike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 27.08.2022 deri me datë 03.09.2022 si datë e mbylljes së shpalljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
  - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.
  - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
  - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
  - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
  - Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
  - Dy rekomandime (nëse keni);
  - Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
  - Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
  - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetim.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin ne fuqi.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu člana 18 i 22 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika Br. 02/2010 o Procedurama Regrutovanja u Civilnoj Službi Kosova, na osnovu Presude br. Ref AGJ.1583/20 od 9 jula 2020 godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje:

**KONKURS**  
**ZA ZAPOSŁJAVANJE NA ODREĐENO VREME**

**I. Službenik za Budžet i Finansije**

Osnovno Tužilaštvo u Prizrenu, jedna (1) pozicija, za devet (9) meseci

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 015  
Naziv radnog mesta: Službenik za Budžet i Finansije  
Pozicija: pozicija Pozicija ne karijere  
Nivo: Profesionalni  
Šifra posla: BF/210  
Izveštava: Administratoru Tužilaštva  
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija  
Koeficient: Sedam (7)  
Akt o imenovanju: Na određeno vreme  
Probni rad: Tri (3) meseca  
Mesto: Prizren

**Svrha radnog mesta:**

Finansijski službenik u okviru organizacione jedinice planira budžetske potrebe, proverava ispravnost računa, ažurira podatke u platnom sistemu za advokate i stručnjake, vodi evidenciju računa i osigurava da se predaja računa vrši u zakonskim rokovima.

**Glavne dužnosti i odgovornosti:**

U konsultaciji sa administratorom i glavnim tužiocem priprema potrebe za pregledom budžeta, budžetske potrebe za sledeću godinu i rano planiranje za naredne 2 godine.

Osigurava da su računi u organizacionoj jedinici redovni, tačni i potpuni i da prati račune i osigurava da ne dolazi do dupliranja računa i da su u zakonskim rokovima.

Registruje i ažurira sistem plaćanja za advokate i stručnjake.

Osigurava da se potraživanja za sitni novac (petty cash) zasnivaju na zakonu i priprema odgovarajuća potraživanja.

Priprema dnevnicu i avansnih zahteva za celo osoblje organizacione jedinice.

Priprema naloge za kupovinu, zahteve za preuzimanje obaveza i izmirivanje obaveza za sve račune organizacione jedinice i osigurava da su svi potpisani od strane službenika za odobravanje.

Sastavlja redovne i ad hoc izveštaje o statusu računa u organizacionoj jedinici i centralnoj organizacionoj jedinici i redovno izveštava o neizmirenim obavezama po fakturi u centralnoj organizacionoj jedinici.

Priprema plan rada u skladu sa zakonom, propisima, politikama i procedurama, unutar određenih rokovima.

Obavlja sve druge dužnosti u skladu sa važećim zakonom koji se mogu povremeno zatražiti na razuman način od strane glavnog finansijskog direktora i direktnog nadzornika;

**Znanje, veštine i sposobnosti za radno mesto:**

Odlčno profesionalno znanje u oblasti javnih finansija;

Odlčno i sveobuhvatno profesionalno znanje vezano za finansije;

Dobro poznavanje računarskih veština i primenijvanje aplikacija (Microsoft Word, Excel, Access, Power Point) i interneta;

Veštine za rad u multietničkom okruženju i za timski rad;

Sposobnost postavljanja najvažnijih ciljeva i davanja prioriteta istima;

Sposobnost preduzimanja konkretnih inicijativa tokom rada i u vezi sa istim;

Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i u radnim uslovima pod pritiskom;

**Profesionalna sprema i kvalifikacije:**

Univerzitetska Diploma, Ekonomski Fakultet.

**Radno iskustvo:**

Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 27.08.2022 do 03.09.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Prishtina, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Prishtina.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:
  - Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
  - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
  - "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne države administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
  - Svedočanstvo školske spreme;
  - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prilovataju kao dokaz radnog iskustva).
  - Dve preporuke (ako imate);
  - Kopije dva poslednja naizmjenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
  - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
  - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

